

RAPORTI VJETOR 2021, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, REALIZUAR NGA
NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka zhvilluar konsultim publik për projektvendimin “Për miratimin e listës së substancave kandidate”, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, me numër 222, në datë 07.04.2021, duke e publikuar aktin në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik si dhe duke zhvilluar takime konsultative të formave të tjera.

Gjithashtu i është nënshtruar një procesi të zgjeruar konsultativ projektvendimi për miratimin e dokumentit të politikave “Për miratimin e dokumentit kombëtar të përcaktuar”, i miratuar me nr. 581, datë 06.10.2021, por që nuk është publikuar në RENJK.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrit vihet re se për VKM 222/2021 ka patur interes nga publiku, duke arritur vlera relativisht të larta të shikimeve.

Mbetet sfida përfshirja më e madhe e publikut në këtë proces, në dhënien e komenteve dhe sugjerimeve me qëllim përmirësimin e akteve. Këtë periudhë raportimi, ndryshe nga vitet e mëparshme, ku takimet konsultative me publikun ishin të zakonshme dhe kryeshin rregullisht, takimet në prezencë u reduktuan plotësisht. Kjo solli një numër më të ulët të komenteve dhe sugjerimeve nga publiku, krahasuar me më parë. Nisur nga ky fakt, ekspertët, shoqëria civile dhe palë të tjera interesi nuk u përfshinë në këtë proces, edhe pse akti ka qenë i publikuar në regjistrin elektronik për një periudhë mbi 20 ditore.

Për periudhën në vazhdim, si mësim i nxjerrë nga viti 2021, duhet t’i kushtohet rëndësi rritjes së cilësisë së konsultimit me publikun, duke përshtatur metoda dhe mjete për të arritur një përfshirje sa më të lartë të këtyre grupeve të interesit.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara gjatë të vitit 2021?

Gjatë vitit 2021 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka miratuar 33 akte në total, nga të cilat 2 akte, kanë detyrim ligjor për t’ju nënshtruar konsultimit me publikun.

Gjithashtu MTM ka miratuar dhe akte të tjera si më poshtë, të cilat, edhe pse nuk janë objekt i konsultimit me publikun, janë konsultuar:

1. VKM “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”;
2. VKM “Për miratimin e kostove të përlogaritura për pyllëzim kompesues në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”;
3. VKM “Për miratimin e listave së llojeve të huaja invazive dhe përcaktimin e procedurave, për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit”;
4. VKM "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 687/2015 'Për miratimin e rregullave përmbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve";
5. VKM "Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të vendit";
6. VKM "Për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjra ose pothuajse të virgjra, si dhe kalimi i tyre në konservim të plotë";
7. VKM "Për masat lidhur me sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO2 gjatë marketingut të automjeteve të reja”;
8. VKM “Për miratimin e dokumentacionit shoqëruar të formularit, afatet dhe procedura e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me deklaratë, si dhe deklarata për arritjen e fazës së zhvillimit përfundimtar të kërimit shkencor”;
9. VKM "Për përcaktimin e kriterëve për hartimin e planeve të menaxhimit, si dhe përcaktimin e ekosistemeve, të habitateve dhe llojeve të faunës së egër me status mbrojtjeje";
10. VKM "Për kriteret e ushtrimit, të miratimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në fondin pyjor kombëtar".

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nga 2 aktet e miratuara, të cilët kanë detyrim ligjor t'i nënshtrohen procesit të konsultimit me publikun, ka konsultuar vetëm aktin **“Për miratimin e listës së substancave kandidate”**, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, me numër 222, në datë 07.04.2021. Procesi i miratimit të këtij akti u shoqërua me procesin e konsultimit publik, siç parashikohet në ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ndërkohë, MTM ka miratuar dhe aktin “Për miratimin e Dokumentit Kombëtar të Përcaktuar”, i cili është konsultuar vetëm nëpërmjet takimeve konsultative, por nuk është publikuar në RENJK.

2.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Për këtë periudhë nuk janë konsultuar akte që janë shoqëruar me VNR.

2.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga PPAP 2021, 8 akte janë përjashtuar nga konsultimi publik. Në PKIE janë planifikuar 6 akte, të cilat nuk janë përjashtuar nga procesi i konsultimit. Lidhur me dokumentet strategjike, të gjithë aktet e planifikuar për miratim në PPAP, janë pjesë e dokumenteve strategjike, dhe vetëm 8 prej tyre janë përjashtuar nga konsultimi publik.

Akti “Për miratimin e listës së substancave kandidate” nuk ka qenë i përfshirë në PKIE apo në ndonjë dokument strategjik sektorial të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, por ka qenë i parashikuar në PPAP 2021. Ndërsa akti “Për miratimin e Dokumentit Kombëtar të Përcaktuar” nuk ka qenë parashikuar as në PPAP 2021 as në PKIE 2021.

2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Akti i konsultuar është vendim i këshillit të ministrave.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Në përgjithësi, situata e konsultimit të akteve që miraton MTM-ja vazhdon të mbetet e njëjtë. Ministria i publikon aktet në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, por interesi nga qytetarët apo palët e tjera të interesit mbetet shumë i ulët. Konstatohet që projektaktet shikon nga një numër i konsiderueshëm qytetarësh, por nuk ka komente.

Situata në krahasim me vitin e kaluar është përmirësuar, pasi MTM ka filluar të konsultojë aktet edhe nëpërmjet takimeve konsultative.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Nisur nga situata e pazakontë e shkaktuar nga pandemia Covid-19, metodatat e konsultimit të aktit “Për miratimin e listës së substancave kandidate” ishin 2, si më poshtë:

- Regjistri elektronik për njoftim dhe konsultim publik;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.

Metodatat e konsultimit të aktit “Për miratimin e dokumentit kombëtar të përcaktuar”, kanë qenë si më poshtë:

- Takime të drejtpërdrejta me grupet e interesit;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Publikimi në regjistrin elektronik të konsultimit publik (për aktin e publikuar) ka qenë i frytshëm sepse ka mundësuar që të interesuarit të shohin aktet, por nuk ka gjeneruar komente. Ndërkohë për aktin “Për miratimin e dokumentit kombëtar të përcaktuar”, takimet me grupet e interesit kanë gjeneruar një numër të konsiderueshëm komentesh.

2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka realizuar konsultime paraprake për PVKM “Për miratimin e listës së substancave candidate”.

Projektvendimi është përgatitur nga MTM në bashkëpunim me ekspertët e Agjencisë Suedeze të Kimikateve (KEMI), në kuadër të Projektit “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve”, që synon krijimin e kushteve, në fushën e legjislacionit për kimikatet, për anëtarësim në BE.

Projektvendimi i propozuar, është diskutuar dhe dakortësuar në takimin online të mbajtur në datë 16.10.2020, midis përfaqësuesve të MTM-së, ekspertëve të KEMI-t, dhe përfaqësuesve të Zyrës së Kimikateve, në AKM.

MTM nuk ka realizuar konsultime paraprake për aktin “Për miratimin e Dokumentit Kombëtar të Përcaktuar”.

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

PVKM “Për miratimin e listës së substancave candidate” është publikuar në regjistrin elektronik të konsultimit publik në datë 17.02.2021 dhe ka qenë i hapur për një periudhë më të gjatë së 20 ditë.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja e konsultimit në regjistrin elektronik ka qenë 20 ditë.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

MTM e respekton afatin kohor ligjor për publikimin e projektakteve.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin 2021?

VKM “Për miratimin e listës së substancave kandidate” është përgatitur nga MTM në bashkëpunim me 3 ekspertë e Agjencisë Suedeze të Kimikateve (KEMI), në kuadër të Projektit “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve”.

VKM “Për miratimin e dokumentit kombëtar të përcaktuar” është përgatitur nga MTM, në bashkëpunim me FAO (Food and Agriculture Organization), GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) dhe UNDP (United Nations Development Programme).

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Anëtarët e jashtëm të grupeve të punës që morën pjesë në hartimin e aktit janë ekspertë ndërkombëtarë në fushën e kimikateve dhe ekspertë për fushën e ndryshimeve klimatike.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuar për projekt-aktet në vitin 2021?

PVKM “Për miratimin e listës së substancave kandidate” është publikuar në regjistrin elektronik të konsultimit publik, por nuk ka patur komente nga publiku. Akti është konsultuar dhe ministritë e linjës, ku janë gjeneruar dhe komente.

Për VKM “Për miratimin e dokumentit kombëtar të përcaktuar” janë dhënë 20 komente nga grupet e interesit të pranishëm në takim.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Për VKM “Për miratimin e dokumentit kombëtar të përcaktuar” janë dhënë 20 komente nga 7 grupe interesi të pranishëm në takim.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët për akte të caktuara. Akti për substancat kandidate ka tërhequr interes më të madh të publikut. Mosinformimi dhe mungesa e kulturës së përfshirjes në hartimin e politikave publike ka sjellë edhe mungesën e reagimeve mbi aket e publikuara për konsultim.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

PVKM “Për miratimin e listës së substancave kandidate”, është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-akte dhe shkresës me nr.1235 prot, datë 15.02.2021, në ministrinë e linjës, konkretisht në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme, të cilat janë shprehur si më poshtë vijon:

Ministria e Drejtësisë, shprehet parimisht dakort, duke sugjeruar riformulimin e titullit të projektaktit me qëllim qartësimin e togfjalëshit “*substancave kandidate*”.

Lidhur me këtë sugjerim, sqarojmë se: në pikën 1.23, të nenit 5, të ligjit 27/2016, jepet termi “Listë kandidate”. Referuar kësaj pike, “*Listë kandidate*”, është lista e substancave që janë duke u konsideruar/shqyrtuar për t’u bërë pjesë e listës SVHC. Gjithashtu, në pikën 1, të nenit 21, të ligjit 27/2016, citohet se: substancat e rrezikshme, të cilat janë kandidate për t’u futur në listën SVHC, përfshihen në listën kandidate. Në këtë këndvështrim, gjejmë se togfjalëshi “*substancave kandidate*”, është i qartë. Sa i përket, titullit të projektvendimit, sqarojmë se ai bazohet në autorizimin ligjor, të dhënë në pikën 2, të nenit 21, të ligjit 27/2016.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në mendimin e saj citon se nuk mund të shprehet mbi përputhshmërinë e projektvendimit të propozuar, pasi nuk synon përafrim të legjislationit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, janë shprehur parimisht dakord.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, janë shprehur parimisht dakord, brenda kompetencave të institucioneve të tyre. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është shprehur pa komente, sa i takon fushës së saj të përgjegjësisë.

Me qëllim njohjen dhe familjarizimin e grupeve të interesit, ekspertëve të fushës dhe qytetarët, me këtë projektvendim, në datë 17.02.2021, projektakti është publikuar, në faqen zyrtare të konsultimit me publikun, por nuk ka ardhur asnjë koment, mendim, ose sugjerim për sa lidhet me këtë projektvendim.

VKM “Për miratimin Dokumentit Kombëtar të Përcaktuar” është konsultuar nëpërmjet takimeve konsultative. Gjithsej, janë marrë 20 komente.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nga 20 komentet e marra nga konsultimi i VKM-së “Për miratimin e Dokumentit Kombëtar të Përcaktuar”, 18 janë pranuar plotësisht, ndërsa 2 janë refuzuar.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Krahasuar me vitet e kaluara, ku takimet publike ishin metoda që gjenerontë numrin më të madh të komenteve, kjo periudhë nuk ishte në një gjendje të kënaqshme, duke qenë se përfshirja e publikut nuk ishte në nivelin ndikues.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuarnë bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Për këtë periudhë nuk janë konsultuar akte që janë shoqëruar me VNR.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka publikuar raportin 6 muajor të konsultimit me publikun.

2.6.2 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsytet?

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Në përfundim, bazuar në vlerësimin e cilësisë së performancës institucionale sipas metodologjisë Sigma, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit renditet në kolonën e dytë (1-3 pikë) për VKM 222/2021, duke qenë se akti u publikua në sistemin e informacionit të qeverisë, por nuk ka përfshirje të aktorëve të interesit. Ndërkohë, për VKM 581/2021, MTM vlerësohet me 0 pikë, duke qenë se akti nuk është publikuar në RENJK.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Në përfundim mund të themi që procesi i konsultimit publik, pavarësisht se është një praktikë që ndiqet prej kohësh tashmë, paraqet sfida të ndryshme, që lidhen herë më situatën në të cilën ndodhet vendi, herë me natyrën e aktit.

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërfshirjen e publikut në këtë proces. Shihet një neglizhencë e qytetarëve, ekspertëve, bizneseve dhe grupeve të shoqërisë civile në pjesëmarrjen në proceset e konsultimit në regjistrin elektronik. Situata e shkaktuar nga pandemia ka ndikuar në gjithë procesin e konsultimit, duke qenë se nuk janë realizuar takimet në prezencë, të cilat gjenerojnë dhe numrin më të madh të komenteve dhe përfshirjen e publikut. Mbetet për t'u identifikuar një zgjidhje alternative për adresimin e kësaj sfide dhe përmirësimin e procesit të konsultimit në tërësi.

Sfidë tjerër që paraqitet në këtë kuadër është dhe mungesa e ekspertizës në një fushë të caktuar. Në rastet e akteve shumë teknike, në fusha shumë specifike, mos-reagimi vjen si pasojë e vështirësisë së të kuptuarit të aktit. Në këtë drejtim, një zgjidhje do të ishte zhvillimi i ditëve informative me palët e interesit, në mënyrë që gjithsecili të kuptojë risitë apo ndryshimet që parashikon akti. Në këtë mënyrë rriten njohuritë e palëve të interesuara për aktet dhe nxitet kështu komunikimi dhe diskutimet mbi projektaktin..